

**AKT THEMELIMI**  
**I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**  
**“BRAHAJ KARBURANT “ SHPK**

**Neni 1: Emri dhe forma ligjore**

Sot më datë 2.05.2018, une i nenshkruari:

1. **XHELAL BRAHAJ**, i datëlindjes 11.07.1966, lindur ne Kukes dhe banues ne Durres, madhore dhe me zotesi te plote per te vepruar, me numër identifikimi G60711005N

themelojme një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin :

**BRAHAJ KARBURANT SHPK**

Shoqeria rregullon veprimtarine e saj ne perputhje me Aktin e Themelimit,Statutin e saj, me ligjin 9901 date 14.04.2008 “Per tregtaret dhe shoqerite tregtare”

**Neni 2: Selia**

**Fshati Rinia, Kryqezimi i Rruges Shkozet - Porto Romano me Rrugen ish-NISH Kimike, Zona Kadastrale 1585, Godine 1- kateshe me nr. Pasurise 13/83, Durres**

Shoqëria mund të hapë edhe seli të tjera operative, filiale, përfaqësi dhe agjensi në të gjithë territorin e Shqipërisë si dhe jashtë saj, në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe ligjet e vendeve ku ato hapen.

### **Neni 3: Objekti**

Shoqëria do të ushtrojë veprimtarinë si më poshtë:

- Tregti me pakicë të karburanteve, lubrifikanteve, lendeve djegëse, te lëshshme dhe te gazta, etj.
- Tregtim të mallrave industriale, ushqimore, mallrave të konsumit të gjere, pije të ndryshme, artikuj higjieno-sanitare, detergjente, artikuj shtëpiake, veshmbathje, materiale të ndertimit, automjeteve e pjesë këmbimi për to, makinerish e pajisje, elektroshtëpiakeve, hidrosanitare, elektrike e elektronike, mobilje, kozmetike, bime medicinale, hidrosanitare, etj
- Aktivitet në fushën e shërbimeve të Restoranteve , Bar-bufë, Minimarket.
- Transport karburanti dhe mallrash brenda dhe jashtë vendit për vetë dhe për të tretë.
- Agjenci udhëtimi.
- Dhënie dhe marrje mjete me qera, asete, pasuri të paluajtshme etj.
- Lavazh, servis.
- Veprimtari në fushën e Ndertimit
- Shoqëria sipas nevojave të aktivitetit ka të drejtën e ushtrimit të çdo aktiviteti të ligjshëm, të lejuar për formën e shoqërisë, e cila nuk ndalohet me ligj(sipas nenit 7 të Ligjit nr.9901,dt.14.04-08).

#### **Neni 4: Kohëzgjatja**

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë pa afat.

#### **Neni 5: Kapitali**

Kapitali i shoqërisë është **4.000.000 (katërmilion )** Lekë, i ndarë në 1 kuote.

Kontributi i ortakëve në kapitalin e shoqërisë është vlerësuar sipas të dhënave të mëposhtme:

**XHELAL BRAHAJ**, është zotëruar i 1 kuote, me 100% pjesëmarrje në kapitalin e shoqërisë me vlerën 4.000.000 leke

#### **Neni 6: Organet drejtuese të shoqërisë**

Organet drejtuese të shoqërisë do të jenë:

(-) Asambleja e Përgjithshme.

(-) Administrator i shoqërisë do të jetë **Z. XHELAL BRAHAJ**, për një periudhë 5 vjeçare me të drejtë riemërimi.

#### **Neni 7: Viti ushtrimor**

Viti ushtrimor fillon me 1 Janar dhe mbaron me 31 Dhjetor.

#### **Neni 8: Dispozitat e fundit**

Shoqëria respekton ligjin dhe statutin që është pjesë e pandarë e këtij akti.

Për çdo gjë tjetër, që nuk është shkruar shprehimisht në këtë statut, zbatohet legjislacioni në fuqi për shoqëritë tregtare, për QKR-në si dhe çdo ligj tjetër mbi veprimtarinë e shoqërive me përgjegjësi të kufizuar.

Emri dhe nënshkrimi i Ortakut të Shoqërisë

**XHELAL BRAHAJ**

